# UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

**November 20-22 | KDWV Members meet Vocational Schools**

## Director's Note

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

OEGJK këtë javë është angazhuar në mënyrë aktive në ofrimin e shërbimeve për anëtarët dhe organizimin e eventeve për të krijuar lidhje të reja me tregun gjerman.

Këtu është një përmbledhje koncize e ngjarjeve kryesore që ndikojnë në operacionet biznesore:

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

KDWV this week has been actively engaged in providing services to members and organizing events to create new connections in the German market.

Here's a concise summary of key events impacting economic developments that influence business operations:

---

### OEGJK mori pjesë në Jubilarin e 20-të të Forumit Ekonomik të Vjenës

Me ftesë të bordit të Forumit Ekonomik të Vjenës, drejtoresha e OEGJK-së, znj. Nora Hasani mori pjesë në Vienna Future Dialogue 2023 që sivjet u mbajt nën moton "Economy meets Politics".

Në kuadër të Forumit, znj. Hasani u takua me akterë të ndryshëm ekonomikë dhe përfaqësues të shoqatave ekonomike, për të intensifikuar mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm.

Si një nga forumet më të njohura ekonomike në botë, në këtë Forum ishte edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, i cili mori pjesë në sesionin "Ndërtimi i bashkëpunimit ekonomik në kohë të vështira" me homologët tjerë nga rajoni, ku dhe informoi të pranishmit për sukseset dhe sfidat e Kosovës.

### KDWV participated in the 20th Jubilee of the Vienna Economic Forum

At the invitation of the board of the Vienna Economic Forum, the director of KDWV, Ms. Nora Hasani, participated in the Vienna Future Dialogue 2023, which this year was held under the motto "Economy meets Politics".

Within the Forum, Ms. Hasani met with various economic actors and representatives of economic associations, in order to enhance opportunities for further collaboration.

As one of the most renowned economic forums globally, the Prime Minister of the Republic of Kosovo, Mr. Albin Kurti, also attended the Forum. He participated in the session "Building Economic Cooperation in Difficult Times" with counterparts from the region, where he informed the attendees about Kosovo's successes and challenges.

---

**Fotografi nga Forumi Ekonomik i Vjenës**

**Photos from Vienna Economic Forum**






## OEGJK ka mbajtur dy Sesione informuese rreth panaireve në Gjermani 2024/25

### Komuna e Mitrovicës

OEGJK ka mbajtur Sesion Informues në Komunën e Mitrovicës, me temën "Mundësitë e pjesëmarrjes së Kompanive Vendore në Panairet në Gjermani 2024/25", në bashkëpunim me KIESA-n.

Përfaqësueset e OEGJK, znj. Besarta Hyseni dhe znj. Elena Elshani, së bashku me z. Mirsad Simnica nga KIESA, u pritën nga Drejtori për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, z. Elvis Feka, i cili mbajti fjalën hyrëse në këtë sesion.

Të pranishmit u informuan për mundësitë e pjesëmarrjes dhe mbështetjes së kompanive kosovare në panairet që organizohen në Gjermani, si mundësi unike për zgjerimin e bizneseve të tyre.

Përfaqësuesit e kompanive gjithashtu patën rastin të informohen dhe mbi shërbimin Senior Expert Service (SES), si dhe impaktin e angazhimit të ekspertëve dhe profesionistëve gjermanë, në përmirësimin dhe zgjerimin e aktiviteteve të tyre.

## KDWV held two Info Sessions about the Fairs in Germany for 2024/25

### Municipality of Mitrovica

KDWV held an Informative Session, in collaboration with KIESA, in the Municipality of Mitrovica with the topic "Opportunities of the Participation of Local Companies in the Fairs in Germany for 2024/25."

Representatives from KDWV, Ms. Besarta Hyseni and Ms. Elena Elshani, along with Mr. Mirsad Simnica from KIESA, were welcomed by the Director for Economy, Development, and Tourism, Mr. Elvis Feka, who delivered the opening remarks for this session.

Attendees were informed on the opportunities for participation and support for Kosovo companies in the fairs organized in Germany, representing a unique chance for the expansion of their businesses.

Company representatives also had the opportunity to learn about the Senior Expert Service (SES) and the impact of engaging German experts and professionals in enhancing and expanding their activities.






**Fotografi nga Info Sesioni në Mitrovicë**

**Photos from the Info Session in Mitrovica**

**Komuna e Pejës**

Në ciklin e sesioneve informuese që po mbahen në qytetet e Kosovës nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, në bashkëpunim me KIESA-n, u vizitua edhe Peja.

Nënkryetari i Pejës, z. Fatmir Asllani facilitoi sesionin informues, në mesin e shumë bizneseve që ishin të interesuara për të mësuar më shumë për “Mundësive për pjesëmarrje të kompanive vendore në panairet gjermane 2024/25”.

Drejtoresha e OEGJK-së, znj. Nora Hasani informoi të pranishmit për panairet, si një prej formave më të mirat për zgjerim të biznesit dhe tregut, duke përmendur edhe shembuj konkret.

Se si mund të përfitohet përkrahje nga KIESA në pjesëmarrje në Panaire, informoi z. Mirsad Simnica, Zëvendësues i Udhëheqësit të Sektorit për Promovim të Eksportit.

Kurse, përfaqësuesja e shërbimit SES (Senior Expert Service), znj. Elena Elshani informoi bizneset se si ato mund të angazhojnë ekspertë gjermanë me një kosto shumë të përballueshme, nëpërmes OEGJK-së.

**Municipality of Peja**

As part of the series of Info Sessions held by the German-Kosovar Business Association, in collaboration with KIESA, Peja was also visited.

Peja's Deputy Mayor, Mr. Fatmir Asllani, facilitated the informative session among numerous businesses interested in learning more about "Opportunities for the Participation of Local Companies in German Fairs 2024/25."

Director of the German-Kosovar Business Association, Ms. Nora Hasani, informed the attendees about trade fairs as one of the best ways to expand businesses and markets, citing concrete examples.

Mr. Mirsad Simnica, Deputy Head of the Export Promotion Sector, informed the businesses on how support can be obtained from KIESA in participating in fairs.

Meanwhile, the Representative for SES (Senior Expert Service), Ms. Elena Elshani, informed businesses on how they can engage German experts at a very affordable cost through the German-Kosovar Business Association.






KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**NEWSLETTER** | November 17th, 2023







**Fotografi nga Info Sesioni në Pejë**

**Photos from the Info Session in Peja**

## KCF ndan 8 grante për projekte inovative

Me një kontribut prej rreth 3 milionë euro, Fondi i Sfidave për Kosovën (KCF) ka financuar 8 projekte inovative në trajnim profesional dhe bashkëpunim me biznese dhe institucione arsimore.

Ngjarja e prezantimit të rezultateve të thirrjes së dytë për aplikim shënoi përmbylljen e procesit dhe ndarjen e 8 granteve për konsorciumet fituese, nga të cilat: 3 shkolla profesionale, 3 universitete dhe 2 shkolla të mesme profesionale.

Fondi ka ndikuar ndjeshëm në konkurrueshmërinë e sipërmarrjeve në Kosovë, duke financuar projekte bashkëpunuese dhe trajnime duale në bashkëpunim me institute të formimit profesional dhe sipërmarrje.

KCF është një iniciativë e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) e financuar me 5.8 milionë euro për grante nga Ministria Gjermane për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (BMZ). Agjencia zbatuese e projektit është Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

## KCF awarded 8 grants for innovative projects

With a contribution of about 3 million euros, the Kosovo Challenge Fund (KCF) has financed 8 innovative projects in professional training and cooperation with businesses and educational institutions.

The event of the presentation of the results of the second call for applications marked the conclusion of the process and the allocation of grants to the winning consortia for 8 projects of which: 3 Vocational Schools, 3 Universities and 2 Vocational High Schools.

The fund has significantly influenced the competitiveness of enterprises in Kosovo, by financing collaborative projects and dual training in cooperation with vocational training institutes and enterprises.

KCF is an initiative of the German Development Bank (KfW) funded with 5.8 million euros in grants from the German Ministry for Economic Development and Cooperation (BMZ). The implementing agency of the project is the Ministry of Education, Science, Technology and

(MASHTI), e cila mbështetet nga një konsorcium ndërkombëtar konsulentësh për të zbatuar programin e përgjithshëm.

Innovation (MESTI), which is supported by an international consortium of consultants to implement the overall program.



**Fotografi nga Ceremonia e Ndarjes se Çmimeve**

**Photos from the Award Ceremony**

**Departamenti për Mbështetje dhe Shërbime të Anëtarëve**

OEGJK krahas shërbimeve të tjera ofron edhe pako për investitorë gjermanë, asistencë në hapjen e degës/firmës në Gjermani, shërbime për hyrje në treg në Kosovë dhe Gjermani, si dhe këshillim për eksport.

Ky departament si shtyllë kyqe e OEGJK-së, ofron përkrahje për anëtarësinë dhe numëron suksese të shumta si:

- 100+ evente, B2B, info sesione në vit;
- 20+ shëbime të konsulencës për anëtarë e jo anëtarë;
- 58 kompani gjermane janë përkrahur nga OEGJK për të investuar në Kosovë;

**Department for Market Entry and Member Support**

KDWV, in addition to other services, also provides, packages for German investors, opening a branch/company in Germany, services for market entry in Kosovo and Germany, as well as export consulting.

This department, as a key pillar of KDWV, offers support to the membership and counts numerous successes such as:

- 100+ events, B2B, info sessions per year;
- 20+ consulting services for members and non-members;
- 58 German companies have been supported by KDWV to invest in Kosovo;

- Adresa e parë për investitorë gjermanë për të marrë informacione rreth tregut kosovar .

Të gjithë të interesuarit për të përfituar nga këto shërbime, mund të kontaktoni: besarta.hyseni@oegjk.org

- The first address for German investors to get information about the Kosovar market.

If you are interested for these services, please contact: besarta.hyseni@oegjk.org



## YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV

**BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:**
ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina
Monday – Friday | 8.30 – 16.30



**Greta Kazia**

HR, Përgjegjëse për Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for Finance and Membership

greta.kazia@oegjk.org



**Besarta Hyseni**

Udhëheqëse e Departamentit mbështetje dhe shërbime të anëtarëve
Këshilltare për Arsim Profesional Dual

Head of Market Entry & Events
Advisor for VET

besarta.hyseni@oegjk.org



**Elena Elshani**

Asistente Ekzekutive
Përfaqësuese për Shërbimin e Ekspertëve Seniorë (SES)

Executive Assistant
Senior Expert Service Representative (SES)

elena.elshani@oegjk.org



**Gonxhe Abazi**

Udhëheqëse e Departamentit për Marrëdhënie Qeveritare dhe Avokim

Head of Department for Advocacy and Government Relations

gonxhe.abazi@oegjk.org



**Eriola Muhaxhiri**

Këshilltare Ligjore

Legal Advisor

eriola.muhaxhiri@oegjk.org